

**Extra Brand's Sh.p.k**  
**Pasqyrat Financiare**  
**për periudhën 23 janar deri më 31 dhjetor 2017**

---

## Përmbajtja

Pasqyrat financiare për periudhën 23 janar deri më 31 dhjetor 2017:

Pasqyra e Pozicionit Financiar .....	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital .....	3
Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare .....	4
Shënime të pasqyrave financiare .....	5-13

# Extra Brand's Sh.p.k

Pasqyra e Pozicionit Financiar  
(shumat në Lekë)

	Shënime	Për periudhën 23 janar deri në 31 dhjetor 2017
<b>Aktivet:</b>		
<b>Aktivet afatgjata:</b>		
Aktive afatgjata materiale	6	444,144
		<u>444,144</u>
<b>Aktivet afatshkurtra:</b>		
Mallra		2,016,642
TVSH		621,157
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre		608,801
		<u>3,246,600</u>
<b>Totali i aktiveve</b>		<u><b>3,690,744</b></u>
<b>Kapitalet e veta:</b>		
Kapitali aksionar		25,000
Humbje e periudhes		(687,973)
<b>Totali i kapitalit</b>		<u><b>(662,973)</b></u>
<b>Detyrimet</b>		
<b>Detyrime afatshkurtra:</b>		
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	7	4,353,717
		<u>4,353,717</u>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit të vet</b>		<u><b>3,690,744</b></u>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar bashkë me shënimet në faqet 5 deri 10, që janë pjesë e pasqrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Administratori i shoqërisë Extra Brand's Sh.a. më 30 mars 2018.

  
Bujar Mehmeti  
Administrator



## Extra Brand's Albania Sh.p.k

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse  
(shumat në Lekë)

	Shënime	Për periudhën 23 janar deri në 31 dhjetor 2017
<b>Të ardhura</b>		<b>25,109</b>
<b>Shpenzimet</b>		
Kosto e mallit të shitur		22,826
Furnitura dhe shërbime	8	292,430
Shpenzime personeli	9	377,011
Shpenzime amortizimi		-
Të tjera	10	735
Humbja neto nga kursi i këmbimit		20,080
<b>Humbja para tatimit</b>		<b>(713,082)</b>
Shpenzimi i tatimit fitimit		-
<b>Humbja neto e vitit</b>		<b>(687,973)</b>
<b>Të ardhura/(humbje) të tjera gjithëpërfshirëse</b>		<b>-</b>
<b>Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse të periudhës</b>		<b>(687,973)</b>

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar bashkë me shënimet në faqet 5 deri 10, që janë pjesë e pasqyrave financiare.

## Extra Brand's Sh.p.k

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

(shumat në Lekë)

	Kapitali aksionar	Humbje të mbartura	Rezerva ligjore	Totali
Kapitali aksionar fillestar	25,000	-	-	25,000
Humbja neto e vitit	-	(687,973)	-	(687,973)
Të ardhura/(humbje) të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
<b>Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për periudhën</b>	-	<b>(687,973)</b>	-	<b>(687,973)</b>
Veprimet me pronarin të regjistruara direkt në kapital	-	-	-	-
Lëvizje të tjera në kapital	-	-	-	-
Transferim në rezerva i fitimit	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>25,000</b>	<b>(687,973)</b>	-	<b>(662,973)</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar bashkë me shënimet në faqet 5 deri 10 bashkëlidhur, që janë pjesë e pasqyrave financiare.

## Extra Brand's Sh.p.k

Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare  
(shumat në Lekë)

		Për periudhën 23 janar deri në 31 dhjetor 2017
<b>Mjete monetare nga aktiviteti operativ:</b>	<b>Shënime</b>	
Humbja para tatimit		(687,973)
<i>Rregullimet për:</i>		
Amortizimin dhe zhvlerësimin		0
Humbje operative përpara ndryshimeve në kapitalin punues		(687,973)
<i>Ndryshime në:</i>		
Rritja në parapagime dhe aktive të tjera		(2,637,799)
Rritja në llogari të pagueshme dhe të tjera detyrime		4,353,717
		1,027,945
Tatim fitimi i paguar		-
<b>Mjete të përdorura në aktivitetin operativ</b>		<b>1,027,945</b>
<b>Mjete monetare nga aktiviteti investues:</b>		
Mjete monetare të arkëtuara nga shitja e aktiveve		-
Mjete monetare të përdorura për blerje të aktiveve		(444,144)
<b>Mjete të përdorura nga aktiviteti investues</b>		<b>(444,144)</b>
<b>Mjete monetare nga aktiviteti financues:</b>		
Mjete monetare të arkëtuara nga rritja e kapitalit aksioner		25,000
<b>Mjete të gjeneruara nga aktiviteti financues</b>		<b>25,000</b>
<b>Rritja neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre</b>		<b>608,801</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës		-
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre më 31 dhjetor</b>		<b>608,801</b>

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare duhet lexuar bashkë me shënimet në faqet 5 deri 10 bashkëlidhur, që janë pjesë e pasqyrave financiare.

# Extra Brand's Sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për periudhën 23 janar deri më 31 dhjetor 2017  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

## 1. Hyrje

Shoqëria Extra Brand's sh.p.k (referuar më poshtë si "Extra Brand's" ose "Shoqëria") është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 23 janar 2017, me NIPT L71323036G.

Shoqëria është themeluar dhe zotërohet nga një aksioner i vetëm që është Bujar Mehmeti, me një kapital të nënshkruar prej 25,000 Lekë për një total prej 1 pjese me vlerë nominale prej 25,000 Lekë.

Extra Brand's ka si aktivitet kryesor tregtim i pjeseve të kembimit për automjete, kamione, autobuze.

Shoqëria ka një administrator Bujar Mehmeti nga 23 janar 2017 deri më 20 janar 2022.

Adresa e Shoqërisë në Shqipëri është "Njesia Bashkiake nr.11, Rruga Isuf Elezi, Ndertesa nr.256, Shqipëri".

## 2. Bazat e përgatitjes

### (a) Deklarata e pajtueshmërisë me parimet kontabël

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombetare të Kontabilitetit (SKK) lëshuar nga Keshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

### (b) Baza e përgatitjes financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

### (c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes së pasqyrave financiare

Këto pasqyra financiare janë të paraqitura në Lekë, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

### (d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon gjykime, vlerësime dhe supozime nga ana e Drejtimit të Shoqërisë, të cilat mund të ndikojnë aplikimin e politikave dhe vlerave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet në vlerësimet kontabël janë njohur për periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe për periudhat e ardhme të ndikuara.

Në veçanti, informacioni rreth gjykimeve të rëndësishme të bëra përshkruhen në shënimin 18 dhe 19 të pasqyrave financiare, kur vlerësohen angazhimet dhe detyrimet e mundshme dhe aktiviteti i shtyrë.

## 3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

### 3.1 Aktive afatgjata materiale

#### (i) Njohja dhe vlerësimi

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë vlerësuar me kosto historike dhe pakësuar për amortizimin e akumuluar (shih më poshtë) apo zhvlerësimin (shih politikën kontabël 3.4).

Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen marrjes dhe përdorimit të aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin kostot e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër të atribueshme për sjelljen e aktivitetit në kushte pune për përdorimin e destinuar të tij.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato pasqyrohen si pjesë të veçanta (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

#### (ii) Kostot e zëvendësimit

Kosto e zëvendësimit të pjesëve të aktiveve afatgjata materiale i shtohet vlerës së mbartur të aktivitetit vetëm nëse parashikohet që kjo pjesë të sjellë përfitime ekonomike në të ardhmen për Shoqërinë dhe kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot që rrjedhin nga përdorimi normal i aktiveve afatgjata materiale janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

#### (iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve llogaritur në bazë të metodës së vlerës së mbetur. Normat vjetore të aplikuara të amortizimit janë si më poshtë:

- Mobilje dhe pajisje 20%
- Mjete transporti 20%

## Extra Brand's Sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për periudhën 23 janar deri më 31 dhjetor 2017  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

### 3.1 Instrumentet financiare

Shoqëria disponon vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbëra vetëm nga mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë dhe llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera.

Instrumentet financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë duke shtuar, për instrumentet e mbajtur jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit/humbjes, çdo kosto transaksioni që lidhet drejtpërsëdrejti me to, përveç siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Kompania vlerëson në fund të çdo periudhe raportuese nëse ka ndonjë evidencë objektive që një aktiv financiar ose grup i aktiveve financiare është zhvlerësuar. Nëse ekziston një evidencë e tillë, Shoqëria mat humbjen nga zhvlerësimi si diferencë midis vlerës kontabël neto të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuara. Shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje.

Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të njësisë raportuese skadojnë, shfuqizohen ose anulohen. Diferenca midis vlerës kontabël të një pasivi financiar dhe shumës së paguar njihet në fitim ose humbje.

Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare jo-derivative maten siç përshkruhet më poshtë:

#### *Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë llogaritë rrjedhëse në banka. Mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar.

#### *Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera*

Llogaritë e pagueshme dhe detyrime të tjera njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar.

### 3.2 Zhvlerësimi

#### *(i) Aktivitetet financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ekzistojnë tregues objektive që një ose më shumë ngjarje mund të kenë ndikim negativ në flukset e pritshme të ardhme që do të gjenerojë ky aktiv.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhme të skontuara me normën e interesit efektiv origjinal.

Aktivet financiare individuale me vlerë të konsiderueshme testohen për zhvlerësim individual. Pjesa tjetër e aktiveve financiare grupohen në grupe me karakteristika rreziku të njëjta. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në fitime ose humbje. Një humbje nga zhvlerësimi rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet objektivist me një ngjarje të ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi fillestar. Rimarrja njihet në fitime ose humbje.

### 3.4 Zhvlerësimi (vazhdim)

#### *(ii) Aktivitetet jofinanciare*

Vlera e mbartur e aktiveve jofinanciare të Shoqërisë është rishikuar në fund të periudhës raportuese për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ekzistojnë tregues të tillë atëherë vlera e rikuperueshme e aktivitetit rivlerësohet. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e aktivitetit tejkalon atë të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në humbje ose fitim.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parave tejkalon vlerën e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm që gjeneron flukse monetare gjerësisht të pavarura nga grupet apo aktivitetet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlera e rikuperueshme e një aktivi apo e një njësie gjeneruese të parasë është më e madhja ndërmjet vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë të tij pasi janë zbritur shpenzimet e shitjes.



## Extra Brand's Sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për periudhën 23 janar deri më 31 dhjetor 2017  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

---

Për të vlerësuar vlerën në përdorim flukset e pritshme të parasë skontohehen deri në vlerën aktuale të tyre duke përdorur një normë skontimi para taksave, që reflekton kushtet e vlerësuarat të tregut dhe vlerën në kohë të parasë si dhe rreziqet specifike që lidhen me këtë aktiv.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka tregues që kjo humbje nuk ekziston më dhe ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret vetëm nëse vlera e mbartur e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e mbartur që do të ishte përcaktuar si vlerë neto pas zbritjes së amortizimit dhe nëse nuk do të ishte njohur humbje nga zhvlerësimi.

### **3.5 Kapitali**

Kapitali është njohur në pasqyrat financiare me vlerën nominale.

### **3.6 Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur rreziqet dhe përfitimet e konsiderueshme lidhur me shitjen transferohen tek blerësi, kur arkëtimi është i mundshëm, kur kostot shoqëruese dhe kthimet e mundshme mund të vlerësohen dhe kur e ardhura matet me besueshmëri.

### **3.7 Përfitimet e punonjësve**

*Kontributet e detyrueshme për sigurime shoqërore*

Gjatë ushtrimit të aktivitetit operativ, Shoqëria kryen pagesa periodike për llogari të punonjësve për pjesën që ligjërisht i takon të paguajë Shoqërisë dhe punonjësve për të kontribuar për fondet e detyrueshme të pensioneve sipas rregullimeve të legjislacionit vendas. Kostot e Shoqërisë janë përfshirë në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur ndodhin.

### **3.8 Shpenzimet**

Shpenzimet janë njohur dhe regjistruar në rezultatin e Shoqërisë në momentin në të cilin ato janë kryer.

### **3.9 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare përbëhen nga fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit të cilat raportohen neto në këto pasqyra financiare.

### **3.10 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së transaksionit.

Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj janë konvertuar në datën e raportimit me normën e këmbimit të kësaj date. Fitimi apo humbja nga elementet monetare është diferenca ndërmjet kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me normën efektive të interesit, dhe pagesave gjatë periudhës dhe kosto të amortizuar në monedhë të huaj e konvertuar me normën e këmbimit në fund të periudhës.

Aktivitetet dhe detyrimet jomonetare të njohura në monedhë të huaj, që janë vlerësuar me kosto historike, janë konvertuar me kursin në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet jomonetare të njohura në monedhë të huaj e që janë vlerësuar me vlerë të drejtë, janë konvertuar me kursin në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë.

## Extra Brand's Sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për periudhën 23 janar deri më 31 dhjetor 2017  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

### 3.11 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale njihet në llogaritë e fitim-humbjes, përveç pjesës që lidhet me elementet që njihen drejtpërsëdrejt në llogarinë e kapitalit ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës aktuale është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose për t'u arkëtuar nga të ardhurat e tatueshme ose humbja për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose të miratuara në datën e raportimit dhe çdo rregullimi të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerat e përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohshme kur të kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar. Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Shoqëria merr parasysh impaktin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse taksa dhe interesa shtesë mund të jenë të pagueshme. Shoqëria beson se përlogaritjet për detyrime tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet, bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, duke përfshirë interpretime të ligjit të taksave dhe eksperiencën e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në llogaritje dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Informacion i ri mund të jetë në dispozicion dhe mund të shkaktojë që Shoqëria të ndryshojë gjykimet në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese. Ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të kenë impakt mbi tatim fitimin në periudhat që ky përcaktim bëhet.

Aktivitetet për tatime të shtyra njihen në atë masë që është e mundur që do të ketë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Aktiviteti tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

### 5. Menaxhimi i rrezikut financiar

Shoqëria ekspozohet ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kreditimit
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion mbi ekspozimin e Shoqërisë ndaj secilit nga rreziqet e sipërpërmendur, objektivat, politikat dhe proceset që ajo përdor për vlerësimin dhe manaxhimin e rrezikut dhe mënyrën e manaxhimit të kapitalit. Shënime të tilla sasiore janë të përfshira gjatë gjithë pasqyrave financiare.

Drejtimi ka përgjegjësinë për hartimin e procedurave për manaxhimin e rreziqeve të Shoqërisë.

Politikat e manaxhimit të rrezikut janë krijuar nga Shoqëria për të analizuar dhe identifikuar rreziqet me të cilat Shoqëria përballet dhe për të përcaktuar metodat e kontrollit dhe caktimin e limiteve sipas të cilave do të monitorohen treguesit e rreziqeve. Politikat dhe sistemet e manaxhimit të rreziqeve janë riparë rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe të aktiviteteve të Shoqërisë.

Instrumentet kryesore financiare të Shoqërisë përbëhen nga mjete monetare në bankë dhe llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera.

#### (i) Rreziku i kreditimit

Ekziston një rrezik kreditimi në momentin që palët nuk arrijnë të përmbushin detyrimet e tyre lidhur me pagesat e llogarive të arkëtueshme.

#### (ii) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj financiare në kohën e maturimit të tyre. Përjasja e Shoqërisë është të sigurojë sa më tepër likuiditete të jetë e mundur që të ketë kurdoherë fonde të mjaftueshme likuide për të përmbushur detyrimet e saj brenda afateve normale apo të forcuara, pa shkaktuar humbje të papranueshme apo rrezikuar reputacionin e Shoqërisë.

#### (iii) Rreziku i tregut

Rreziku i kurseve të këmbimit

Shoqëria kryen transaksione kryesisht në Lekë dhe në Euro. Rreziku i monedhës kryesisht manaxhohet duke përdorur parimet e përputhjes së të drejtave dhe detyrimeve. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë marrëdhënie mbrojtëse apo për produkte derivative më 31 dhjetor 2017.

## Extra Brand's Sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për periudhën 23 janar deri më 31 dhjetor 2017  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

6. Aktive afatgjata materiale	Mobilje dhe pajisje	Mjete transporti	Totali
Kosto			
Shtesa	6,950	437,194	444,144
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>6,950</b>	<b>437,194</b>	<b>444,144</b>
Amortizimi i akumuluar			
Shtesa	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Vlera e mbartur			
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>6,950</b>	<b>437,194</b>	<b>444,144</b>

7. Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	31 dhjetor 2017
Paga të pagueshme	286,894
Sigurime shoqërore e tatim mbi të ardhura personale	29,574
Tatim në burim i pagueshëm	34,650
Qir ate pagueshme	196,350
Te pagueshme ndaj ortakut	3,806,249
	<b>4,353,717</b>

8. Furnitura dhe shërbime	Për periudhën 23 janar deri me 31 dhjetor 2017
Shërbime noteriale	3,500
Shpenzime qiraje	231,000
Taksa, tarifa e kuota	14,000
Të tjera	25,903
Komisione bankare	16,410
Shpenzime komunikimi dhe utilitete	1,617
<b>Totali</b>	<b>292,430</b>

9. Shpenzime personeli	Për periudhën 23 janar deri me 31 dhjetor 2017
Paga e kompensime	323,000
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	54,011
	<b>377,011</b>

Më 31 dhjetor 2017, Shoqëria kishte 2 punonjës.

### 10. Të tjera

Të tjera në vlerën prej 735 Lekë konsiston në penalitete të paguara ndaj organeve tatimore për pagesë të vonuar të detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

### 11. Detyrime të mundshme dhe angazhimet

Gjatë rrjedhës normale të biznesit, Shoqëria mund të përfshihet në veprime dhe çështje të ndryshme. Sipas opinionit të drejtimit, Shoqëria nuk është përfshirë në çështje gjyqësore ose në detyrime të mundshme tatimore që mund të kenë efekt në pozicionin financiar apo ndryshime në aktivet neto të Shoqërisë.

Shoqëria nuk ka pasur angazhime kapitale të kontraktuara apo angazhime të tjera më 31 dhjetor 2017.

## **Extra Brand's Sh.p.k**

Shënimet e pasqyrave financiare për periudhën 23 janar deri më 31 dhjetor 2017

*(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)*

---

### **12. Aktiv i tatimor i shtyrë**

Shoqëria rezulton me humbje tatimore për periudhën 23 janar 2017 deri në 31 dhjetor 2017. Shoqëria nuk ka njohur një aktiv tatimor të shtyrë që krijohet nga humbjet tatimore të papërdorura, pasi Shoqëria gjykon se nuk ka evidencë bindëse që tregon shumën e fitimit të tatueshëm që do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit Shoqëria do të përdorë humbjet tatimore të papërdorura ose kreditimet tatimore të papërdorura.

### **13. Ngjarje të mëvonshme**

Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje të ndodhur pas datës së raportimit, e cila mund të kërkonte rregullime apo shënime të tjera në pasqyrat financiare.